

  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"**  
**REKTORATI**

Nr. 825 Prot.

Gjirokastrë, më 18/07/2022

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin e Kretës.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Kretës ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:

**4 pozicione** për studentë të ciklit të parë (Bachelor), të cilët do të angazhohen në mësimnxënie për periudhën Shtator-Dhjetor në Universitetin e Kretës.

Aktivitetit mësimor do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2022-2023**, semestri i parë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B1. Sipas marrëveshjes me Universitetin e Kretës, aplikimet janë të hapura për Fakultetin e Infermierisë.

Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **24.07.2022**:

Për studentët:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në shqip dhe në anglisht.
- një provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuara më sipër.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet Universitetit të Kretës, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

**Prof. dr. Bektash Mema**

**REKTOR**

